# KAPITULLI DHJETE

# POLITIKA E ZHVILLIMIT TE ZONAVE TE THELLA

## 10.1 HYRJE

Qellimi i ketij kapitulli eshte pershkrimi i nje politike gjitheperfshirese per zhvillimin e zonave malore te thella. Megjithate, kjo zone eshte mjaft e gjere dhe planifikimi i detajuar mund te behet vetem permes perfshirjes aktive te fshatrave dhe komunave. Prandaj, ky kapitull mund te shihet si nje tregues per nje perqasje me te pergjithshme.

Struktura e planifikimit te zonave te thella bazohet ne perqasjen konceptuale te meposhtme. Kjo eshte permbledhur ne Kapitullin 3. Ne kete seksion ne diskutojme token dhe rruget kryesore rurale sebashku. Megjithate, rruget strategjike rajonale/kombetare diskutohen ne nje seksion me te hershem.

Siç pershkruhet ne Kapitullin 3, plani propozon te percaktoje disa fshatra si 'Nyje Ekonomike Rurale' (d.m.th. qendra biznesi dhe punesimi) dhe disa si 'Fshatra Kyçe' (d.m.th. qendra sherbimi) dhe disa si 'Fshatra Mbeshtetes' qe varen nga Fshatrat Kyçe per sherbime. Fshatrat e tjere do te lihen te bien. Fshatrat jane mbledhur ne 'Grupime' ne nje rreze 5 km (ne harte) dhe grupimet jane organizuar ne 'Grupe' pergjate nje rruge rurale.

## 10.2 RRUGET RURALE

Ka tre kategori te rruges rurale.

- ***Lloji A.*** kjo lidh qytetet ne rajonin urban me Nyjet Ekonomike me rruge te shtruara 5 m te pershtatshme per kamione me permasa te mesme.
- ***Lloji B.*** Keta lidhin Nyjet Ekonomike me Fshatrat Kyçe me rruge te shtruara 3 m.
- ***Lloji C.*** Keta lidhin 'Fshatrat Mbeshtetes' me Fshatrat Kyçe me rruge te pashtruara, qe mirembahen rregullisht ne nje standart te mire.

Fshatra te rendesishem qe jane te vendosur mes grupimeve quhen 'Fshatra Ndermjetes' dhe jane burime te shperndara ne nje kategori me vete: shih me poshte.

Supozohet qe kostot per kilometer per rruget rurale jane si me poshte.

| | **Kosto per kilometer** | |
|---|---|---|
| | Leke | Euro |
| A | 200,000 | 1,660 |
| B | 50,000 | 920 |
| C | 15,000 | 125 |

**Tabela 10.1 Kostot per Rruget Rurale**

## 10.3 TIPET E FSHATRAVE

### 10.3.1 Nyjet Ekonomike

Keto planifikohen te behen fshatrat (ose qytetet e vogla) me te rendesishme ne zonat e thella. Nyjet Ekonomike Rurale perfshijne keto dhjete fshatra: Vermosh, Rrepsh, Dedaj, Drisht, Koman, Mnele e Madhe, Korthpule (ose Gomsiqe,) Qafe Mali, Fierze, Poshqesh (ose Reps). Ata jane relativisht afer rajonit urban, (ndoshta rreth 10 km nga nje zone rritjeje kryesore) pergjate nje rruge kyçe te 'Llojit A'. Ne parashikojme nje buxhet *mesatarisht* prej 30,000 € per 0,25 ha toke te sherbyer per punishte te vogla, fabrika ose zyra etj. Lehtesira specifike mund te jene frigoriferim, paketim, trajtim qumeshti, logjistike, pergatitje ushqimi, kasap, prodhime druri, prodhime artizanale etj. Çdo nyje ekonomike do te perfshije edhe nje projekt 'Fshati Kyç' siç pershkruhet me poshte.

Megjithate, aty ku nyjat ekonomike jane qytete, ne kemi marre parasysh qe siperfaqja e tokes do te jete mesatarisht 0,5 ha. Buxheti supozohet te jete 60.000 €. Keto nyja ekonemike do te jene Fushe-Arrezi, Puka, Rresheni, Rubiku, Miloti, Laçi dhe Mamurrasi.

### 10.3.2 Fshatrat Kyçe

Keto planifikohen te jene qendra e nje grupimi 'Fshatrash Mbeshtetes' dhe do te sigurojne shkolla dhe qendra shendetesore per te gjithe grupimin.

Fshatrat Kyçe do te lidhen me Nyjat Ekonomike me nje rruge rurale te 'Llojit B'. ideale do te ishte qe fshatrat kyce te jene te vendosura ne nje vendosje lineare te fokusuara ne nje rruge te vetme. Fshatrat Mbeshtetese do te lidhen nese eshte e nevojshme me fshatrat kyçe me nje rruge te 'Llojit C' (megjithese shume fshatra mbeshtetes jane te vendosur ne rruge te Llojit B ose Llojit A). Per momentin shume fshatra kane shkolla dhe qendra shendetesore, por keto nuk jane gjithmone te vendosura racionalisht dhe nganjehere jane shume te vogla per te qene

| GRUPI | GRUPIMI | NYJA EKONOMIKE | FSHATI KYÇ | FSHATI MBESHTETES | FSHATI NDERMJETES | LLOJET E RRUGEVE | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | A | B | C |
| VERMOSH-HOT-DEDAJ | Tamara | | Tamara | Broja<br>Kozhnja | Vuk<br>Nik<br>Selce | | | Tamara-Nik |
| | Vermosh | | Vermosh | Kui i Vermosh liqenit | Tepishta | | | |
| | Rrapsh | Rrapsh | | Kastrati<br>Hoti | | Hani Hotit - Rrapsh | Rrapsh - Vermosh - border | Vermosh-Liqenit<br>Vermosh-Kui i Vermoshit |
| | Dedaj | Dedaj | | Bratosh<br>Vuc Kurtaj<br>Vrith<br>Bzheta<br>Goraj Budisha<br>Zagora | | Koplik - Dedaj. Rrapsh - Dedaj | Shkoder - Qafe Grade - Dedaj | Dedaj-Bzheta |
| | Qaf Grade | | Qaf Grade | Lohja<br>Repisht<br>Kok Papaj<br>Kurt Kullaj<br>Rec | Boga | | | Qaf Grade-Repisht/Kurt Kullaj |
| SHOSH-SHALE-THETH | Nicaj-Shale | | Nicaj-Shale | Grimaj<br>Nenmavric<br>Lotaj<br>Lekaj<br>Abat<br>Vuksanaj<br>Pecaj | Theth | | Drisht-Theth-Boge | Nicaj-Pecaj-Nenmavric etc. |
| | Kir | | Kir | Nicaj-Shosh<br>Plan<br>Pog<br>Mgulla<br>Xhan<br>Brucaj | | | | Kir-Xhan<br>Kir Brucaj<br>Kir Plan |
| | Drisht | Drisht | | Shakote<br>Domen<br>Ura-Shtrenjte<br>Vilza<br>Mareku<br>Kullaj<br>Dragoc<br>Boks<br>Mes<br>Myslim<br>Ukbibaj | Prekali | Shkoder-Drisht | | Drisht-Ukbibaj-Mareku<br>Drisht-Shakote<br>Drisht-Dragoc |
| UNGREJ-KOMAN | Korthpule | | Korthpule | Gomsiqe<br>Vrith<br>Gjobardhaj<br>Kaftalla | | | Korthpule – Vig | Gomsiqe - Kaftalla<br>Korthpule - Vrith |
| | Mnele i Madh | Mnele i Madh | | Mnele i Vogel | Vig | Vau i Dejes - Mnele i Vogel | | |
| | Ungrej | | Ungrej | Karlivac<br>Suxhalia<br>Ramza<br>Frengjin<br>Kalori<br>Kashnjet | Kacinar<br>Vau Krupe | | Mnele - Ungrej - Poshqesh<br>Kallmet - Ungrej | Ramza - Kashnjet<br>Ungrej - Suxhalia<br>Vau Krupe - Kacinar |
| | Koman | Koman | | Qerreti<br>Palaj<br>Vukjana<br>Gegaj<br>Bushat | | Vau i Dejes - Koman | | Koman - Vukjana-Gegaj |
| | Puke | Puke | Qelza | Dedaj<br>Qerret<br>Kabash<br>Blinisht<br>Rrape | Levrushek<br>Dushnaz | | Qelza<br>Koman<br>Qelza - Rrape | Qelza - Qerret |
| | Puke | Puke | Qelza | Dedaj<br>Qerret<br>Kabash<br>Blinisht<br>Rrapaj | Levrushk<br>Dushnaz | | Qelza<br>Koman<br>Qelza per Koman | Dushaj per Toplan |
| | Fierze | Fierze | | Kokoda | | | | Dushaj per |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Bugjoni<br>Breg Lumi<br>Selimaj<br>Poruvi<br>Toplan | | | | Toplan |
| Qafe Mali-Fierze | Lekbibaj | | Lekbibaj | Salca<br>Palci<br>Aprripa<br>Gjonpepaj<br>Betosha<br>Pepaj | | | Fierze per Lekbibaj | Lekbibaj per Salci/Palci<br>Lekbibaj per Ura e<br>Betosha per Aprripa |
| | Dardha | | Dardha | Aztri<br>Meziu<br>Qibiku | Maliska | | | Maliska per Astri<br>Merzik per Dardha<br>Meziu per Dardha |
| | Flet | Qafe Mali | Flet | Vethi<br>Kukumbi | | | | Vethi per Kukumbi |
| | Fushe-Arrez | Fushe-Arrez | | Kryezi<br>Lumbardhi<br>Micoj | Iballa<br>Sapaci | | Fushe-Arrez per Iballa per Fierze | Iballa per Sapaci |
| | Gojan i Siperm | | Gojan i Siperm | Shkoze<br>Kalivar<br>Gojan i Vogel<br>Gjegjan<br>Domi | Lumzi | | | Gjegjan-Domi |
| **Fan** | Reps | Poshqesh | Reps | Spac<br>Koder Spac<br>Orosh<br>Blinisht<br>Bashar | Simon | | | Reps per Spac per Orosh Bashar |
| | Klos | | Klos | Konaj<br>Bisaku<br>Shengjin<br>Zall Xhuxha<br>Dom Gjoni | Thirre | | Poshqesh<br>Klos | Klos per Rrugen<br>Kukes per Shengjin per<br>Klos per Dom Gjoni |
| **Mirdite** | Rubik | Rubik | | Rreja e Veles<br>Rrezi<br>Reje<br>Munaza<br>Guri i Madh<br>Katund i Vjeter<br>Bulshize<br>Rrasfiku<br>Fierza<br>Fangu<br>Rrethi | | | | Rubik<br>Rreja Veles<br>Rubik per Guri/Katundi<br>Fierze per Rrasfiku |
| | Rreshen | Rreshen | | Shegrop<br>Uje Shtreze<br>Prosek<br>Perlat i Siperm | | | | Rreshen per Shegrop<br>Rreshen per Koder R<br>Rreshan per Sheshaj |
| | Perlat | | Perlat | Urak<br>Uje Shtrezi<br>Prosek<br>Perlat i Siperm | | | | Uje Shtrezi per Prosek<br>Perlat per Shlepia |
| | Kurbnesh | | Kurbnesh | Zajsi<br>Bardhaj<br>Lekundaj<br>Kthellaj | Rreshen per Perlat<br>(dhe Burrel) | | Perlat-Kurbnesh (dhe Liqenet Lure) | Kurbnesh per Kthellaj |

**Table 10.2 Identifikimi i Projektit te Zhvillimit Rural:**

ekonomikisht shume mire. Parimi tani eshte qe te sigurohet qe çdo fshat kyç ka nje ndertese shumefunsionale Arsimimi/Shendetesore (qe ka nje shkolle fillestare, tetevjeçare dhe te mesme dhe nje qender shendetesore, te menduar per te lejuar shume perdorime per nje game te gjere te qellimeve komunitare).

Ndertesat ekzistuese duhet te integrohen ne kete sistem. Kjo mund te perfshije zgjerimin dhe riparimin e disa ndertesave ekzistuese; shitjen ose edhe shembjen e te tjerave, ose ndryshimin e perdorimit te tyre. Ne propozojme nje buxhet mesatar prej 200,000 € per grupim, por me pare nevojitet nje studim thelbesor. Tema shpesh quhet 'menaxhimi i Lehtesirave' (dhe eshte nje ekspertize me vete)

### 10.3.3 Fshatrat e Ndermjetem

Ka disa fshatra te rendesishem qe jane mes grupimeve, qe jane te izoluar si natyre, (edhe pse mund te jene te medhenj). Keta nuk mund te perfshihen ne ndonje grupim dhe ne keto raste politika eshte te sigurohet nje version me i vogel i ndertesave te Arsimimit/Shendetesore te permendura me lart.

Ne propozojme nje buxhet mesatar prej 100.000 € per fshat, duke ditur qe nuk do te kete shkolle te mesme.

### 10.3.4 Fshatrat ne Renie

Ashtu siç e shpjeguam ne Kapitullin 3, synimi strategjik eshte menaxhimi i reduktimit te paevitueshem te popullsise ne menyren me racionale dhe me pak te dhimbshme te mundshme. Prandaj, ne menyre qe te forcohet modeli i fshatit ne te ardhme, fshatrat e vegjel dhe te thelle do te lejohen te bien. Rruget per tek keto fshatra do te mirembaheshin vetem per qellime humanitare derisa ata te braktisen. Ne Tabelen 10.1, ne cilesojme grupet e propozuara, nyjet ekonomike, fshatrat kyçe, fshatrat e ndermjetem dhe projektet e rrugeve rurale.

Eshte e rendesishme te thuhet qe puna e konsulenteve ketu nuk ka qene ne thellesine e duhur. Eshte treguese e parimeve te drejta, por ne mendojme qe **eshte e rendesishme te perfshihet komuniteti lokal ne procesin e planifikimit perpara se te veprohet**.

### 10.3.5 Identifikimi i Projektit te Integruar per Zhvillimin Rural

Shih Tabelen 10.1. Kjo identifikon gjashte 'grupet' hapesinore dhe gjashte kategorite e buxhetit, duke treguar tridhjetegjashte komponentet rrjedhoje te buxhetit qe mbulon projektet e Nyjeve Ekonomike, Fshatrave Kyçe dhe Fshatrave Ndermjetes plus tre llojet e investimit te rrugeve.

## 10.4 KOMENTE MBI GRUPET RURALE

- ***Grupi Vermosh-Hot-Dedaj***
  Kjo bazohet rreth rruges Hani Hotit-Vermosh qe shkon afer kufirit. Shih Figuren 10.1. duhet te shtrihet ne veri pertej kufirit dhe te lidhet (permes Plaves) me Lidhjen Strategjike PodShkod – Peje (Kosove). Nyjet Ekonomike do te jene ne Vermosh dhe Rrapsh ne kete rruge dhe gjithashtu ne Dedaj (qe eshte ne rrugen Theth – Shale – Shosh: shih me poshte). Nyjet ne Dedaj dhe Rrapsh do te lidhen me PodShkod me Rruge te Llojit A gjithashtu edhe me njera – tjetren.

  Fshati Kyç ne Tamare do te lidhet me Nyjen Ekonomike Rrapsh me Rruge te Llojit B, qe do te vazhdoje ne Vermosh dhe Mal te Zi. Nyja Ekonomike ne Dedaj do te lidhet permes Boges, Thethit dhe Grupimet ne Nicaj – Shale dhe Kir me Nyjen Ekonomike ne Drisht me nje Rruge te Llojit B: shih me poshte.

- ***Grupi Drisht-Shosh-Shale***
  Shih Figuren 10.1. Kjo bazohet ne rrugen nga Shkodra permes Shoshit dhe Shales ne Theth, (dhe qe ketu ne Dedaj dhe Koplik permes Boges siç pershkruhet ne paragrafin e fundit). Drishti do te jete nje Nyje Ekonomike dhe lidhja Shkoder – Drisht duhet te jete rruge e Llojit A. Rruga Drisht-Kir-Nicaj Shale-Theth-Boge-Dedaj duhet te jete nje rruge e Llojit B.

- ***Grupi Ungrej-Koman***
  Shih Figuren 10.2. Grupimi Ungrej bazohet ne nje rruge kryesore qe lidh Vaun e Dejes (ne PodShkod) me Grupin e Fanit ne Poshqesh: (shih me poshte). Ka dy nxitje te shkurtra ne kete rruge kryesore. Njera çon ne jug ne Kallmet dhe nje ne veri ne Lidhjen Strategjike PodShkod – Kosove ne Korthpule (ose Gomsiqe). Nyjet Ekonomike jane ne (a) Gomsiqe ose Korthpule ne Lidhjen me Kosoven; (b) Mnela e Madhe, krejt afer Vaut te Dejes; (c) Koman, qe lidhet permes Qelez me Rrape ne Lidhjen Strategjike me Kosoven me nje rruge te Llojit B. Komani eshte i lidhur tashme me Vaun e Dejes, por kjo rruge ka nevoje per

mirembajtje. Eshte krejtesisht e aresyeshme te shihet Puka si nje Nyje Ekonomike, e aksesuar pergjate rruges strategjike te Kosoves nga Rrape.

- ***Grupi Fierze-Fushe Arrez***
  Shih Figuren 10.1. Grupimet e bazuar ne Fierze, Dardhe dhe Flet jane te vendosura ne Rrugen Strategjike nga Gjakova, Tropoja dhe Bajram Curri, qe lidhet me rrugen PodShkod – Prizren ne Qafe Mali. Grupimet e bazuar ne Qafen e Malit duhet te jene nje Nyje Ekonomike, siç duhet te jete edhe Fierza, (sepse te dyja shtrihen ne nje rruge strategjike). Nje rruge i Llojit B duhet te lidhe Fierzen me grupimin e Lekbibaj, (por vini re qe kjo eshte ne rrethin e Tropojes).

  Ne gjithashtu propozojme te mbajme rrugen Fushe Arrez-Kryezi-Iballe ne nje standard te Llojit B dhe ta shtrijme ate ne nje gjurme te vjeter deri ne Fierze. Rruga Kryezi-Lumbardhe-Micoj-Fushe Arrez duhet te mbahet si pjese e grupimit te Fushe-Arrezit ne standardet e Llojit C dhe Fushe-Arrezi do te jete nje Nyje Ekonomike.

- ***Grupi i Fanit***
  Ky perfshin tre grupime. Shih Figuren 10.3. Ato te Gojanit te Siperm dhe Repsit jane ne ose afer Rruges Dytesore Strategjike qe lidh Fushe-Arrezin me Milotin. Grupimi i Klosit lidhet me rrugen strategjike ne Poshqesh, (ku eshte e vendosur Nyja Ekonomike) dhe vazhdon permes grupimit te Ungrej ne Vau i Dejes.

- ***Grupi i Mirdites***
  Shih Figuren 10.3. Ky perfshin kater grupime. Ata ne Rubik dhe Rreshen jane Nyje Ekonomike te bazuara ne rrugen strategjike mes Milotit dhe Fushe-Arrezit. Nje rruge dytesore strategjike duhet te lidhe kete rruge te Fushe-Arrezit (permes grupimit te Perlatit) me Burrelin, qe shtrihet jashte Qarkut te Lezhes. Ketu ajo do te lidhet ne lidhjen kombetare te propozuar nga Tirane-Durres ne Maqedoni permes Dibres: Shih Kapitullin 3. Nga Perlati, nje rruge Lloj B do te çoje ne grupimin e Kurbneshit dhe te vazhdoje me thelle ne zonen turistike te Liqeneve te Lures. Ka miniera te konsiderueshme ne kete zone me nje sasi te konsiderueshme mbetjesh industriale dhe ndotje. Ne kemi shperndare nje buxhet shtese per te trajtuar kete ne menyre qe te permiresohet potenciali per rikuperim.

## 10.5 KURBINI

Ketu ne merremi me qytetet e vogla te Milotit, Laçit dhe Mamurrasit qe shtrihen ne rrugen e vjeter nga Lezha ne Tirane permes Fushe-Krujes, (paralel me rrugen e re Tirane – Lezhe). Siç kemi vezhguar ne Kapitullin 3 ato kane plage papunesie te larte. Ne kemi propozuar qe pupullsia te qendroje me mire stabel, ne menyre qe çdo rritje ekonomike mund te jape perfitimet me te mira te mundshme per fryme. Mjedisi eshte i ndotur nga industria e vjeter dhe qytetet jane joterheqese per shkak te renies fizike te tyre.

Ne syrin tone, shpresa e vendosur lokalisht ne turizmin ne breg eshte shume optimiste. Mjedisi aty po perkeqesohet pjeserisht per shkak te zhvillimit te padisiplinuar te strehimit. Shpresa afat-gjate kerkon qe mjedisi i bregdetit te lejohet te rikuperohet nga nje ‘ngrirje’ per ndertimet e reja dhe nje programi afat-gjate per rikuperimin mjedisor.

Ne periudhe afat-shkurter, shpresa me e mire shtrihet ne rikuperimin e bujqesise te pakten, dhe gjithashtu ne direktivat e reja ne agrobiznes, (siç diskutohet ne Kapitullin 8 mbi ‘Zhvillimin Ekonomik’).

Nje mundesi e dyte mund te linde nga shfrytezimi i mençur i rruges Tirane – Veriu i Shqiperise. Per momentin ka probleme. Rruga ka shume perpjekje te bizneseve ekonomike margjinale qe kane akses ballor. Dukja eshte e tmerrshme dhe do te minose vleren strategjike te rruges. Qytetet jane te lidhur keqas me rrugen.

Prandaj ky Plan propozon qe te gjithe bizneset ilegale pergjate kesaj rruge te rishikohen dhe shumica te shemben. Duhet te krijohen breza te rinj mbjelljeje. Rruga strategjike nga Kosova duhet te shtrihet nga Miloti ne rrugen e re te Tiranes. Ne kryqezimin e tyre mund te krijohet nje nyje biznesi terheqese, (ndoshta 1 ha). Rruga nga Miloti ne Fushe-Kruje (dhe Kosove) duhet te lidhe gjithashtu Burrelin duke

permiresuar rrugen ekzistuese. Ne Burrel duhet te bashkoje Tirane – Diber – Maqedoni: kjo eshte permendur ne Kapitullin 3. Kjo do ta vendoste Milotin ne nje vend me potencial, por vetem nese (a) rruga lidhet pasi kalon Milotin ne rrugen e Tiranes dhe (b) krijohet nje nyje e qendueshme biznesi ne kryqezim, dhe (c) zhvillimi ballor i rruges se Tiranes kontrollohet, permiresohet dhe menaxhohet si duhet.

## 10.6 TURIZMI MALOR

Ky eshte diskutuar ne Kapitullin 8 me siper. Vendet e propozuara gjenden ne Vermosh, Theth, Liqeni Vau i Dejes, Fani i Vogel, Shiroke dhe Zogaj, Liqenet e Lures dhe Lugina e Drinit Qendror. Tema permendet ketu per hir te plotesise se trajtimit tone te zhvillimit rural. Zonat Turistike tregohen ne Figurat 10.1 deri 10.3.

## 10.7 BUXHETI I PROJEKTIT

Ne Tabelen 10.3 permbledhim buxhetin, i cili ndahet ne gjashte ‘grupe’ (te pershkruara me siper) dhe me pas te ndara ne dy faza te barabarta. Ne po parashikojme nje program dhjete vjeçar.

| **Grupi** | **Fazat** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **I.** | **II.** | **III.** | **IV.** |
| 1. Vermosh | 0,57 | 0,57 | - | 1,14 |
| 2. Shosh-Shale-Theth | 0,47 | 0,47 | - | 0,94 |
| 3. Ungrej-Koman | 0,37 | 0,37 | - | 0,75 |
| 4. Qafe Mali-Fierze | 0,58 | 0,58 | - | 1,17 |
| 5. Fan | 0,38 | 0,38 | - | 0,76 |
| 6. Mirdita | 0,79 | 0,79 | - | 1,59 |
| **Totali** | **2,78** | **2,78** | **-** | **5,56** |

**Tabela 10. 3 Kostot e Programit te Zhvillimit Rrural**